



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 07.06.2023

## Procesverbal i dëgjimeve Buxhetore për kornizën afatmesme buxhetore 2024 – 2026 me Grupin e Grave

**Vendi i takimit:**

Salla e Kuvendit Komunal

**Ora:**

14:00

**Përfaqësuesit institucional:**

Latif Ramadan, Anila Reçica, Safete Amerllahu,  
Elmaze Behluli, Visar Kozhani, Hyra Bytyqi

**Pjesëmarrësit**

Grupi i Grave

**Përgatitja e procesverbalit**

Grupi punues për hartimin e planifikimit të  
projekt buxhetit 2024-2026

**Numri i pjesëmarrësve:**

51

**Burra:**

3

**Gra:**

48

**Prezantimi i Buxhetit:**

Drejtori për Buxhet dhe Financa Latif Ramadani, ka bërë hapjen e takimi dhe ka prezantuar planifikimin e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024-2026.

Gjatë këtij takimi drejtori për Buxhet dhe Financa ka prezantuar planifikimin e buxhetit të Komunës së Lipjanit dhe ka pranuar të gjitha kërkesat që kanë dalur nga këto takime. Ai po ashtu ka inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë sa më shumë në këto takime sepse kanë rëndësinë e veçantë dhe është mundësia më e mirë përfshirjen e kërkesave të qytetarëve. Si dhe ka falenderuar për pjesëmarrjen në takimin e parë për kornizën afatmesme buxhetore 2024 – 2026 me theks të veçantë investimet kapitale dhe investimet tjera të cilat do ti bëj komuna për gjatë viteve 2024 – 2026.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### Pyetjet e qytetareve:

**Lumturie Bytyqi Hasani** – Kam kërkuar që të rriten subvencionet ose në drejtorin e shëndetësisë ose në zyrën e kryetarit që të mund ti subvencionojmë kategoritë ndryshme, çështja tjetër që dua ta ngrit edhe pse e kam ngritur edhe në Kuvendin Komunal, ju e dini që komuna ka ngritur disa shtatore në qytetin e Lipjanit edhe pse ky projekt ka përfunduar, gjatë diskutimi me kryetarin ai ka thënë se do të dal me një memorial për të gjithë dëshmorët dhe unë jam pajtuar mirëpo Komuna e Lipjanit e ka vetëm një dëshmor femër Zylfije Gashin dhe mendoj që krahas burrave që ju kemi ngritur shtatore të cilët unë e kam përgëzuar komunën mendoj që komuna duhet të vendos një shtatore edhe për Zylfije Gashtin, çështjen tjetër që dua ta ngrit veç e përmendi prej këtij viti zyra për barazi gjinore e cila e ka një nën kod buxhetor 4 mijë euro jo me 10 perqind po mënoj që duhet të dyfishohet ajo shumë sepse zyra për barazi gjinore ka shumë aktivitete ka një plan mjaft të detajuar dhe të gjatë e cila ka kosto po ka raste si grup i grave ju drejtëhemë për ndonjë mbështetje por natyrisht nuk kanë mjete për me na mbështet prandaj do të ishte mirë që kësaj zyre ti dyfishohet në 8 mijë euro për vitin e ardhshëm.

**Ganimete Qeriqi** – Disa kanë kërkuar makina për mjetet e lopëve, me ju siguru sistemi i ujitjes për kopshte mjetë motorike për kopshte të rejat më u mundësu trajnime profesionale për gastronomi, rrobaqepës, parukierin, granate për serra, fidanë edhe më u mbikëqyr më ju ndihmu se disa mund të përfitojnë këto por nuk kanë njoburi qysh mbillen derisa ato të kenë qëndrueshmëri.

**Qendresa Sllamniku** – Propozimi im është krijim i një qendër të trajnimit të kafshëve ose geneve endacak pasi që bredhin shumë në rrugët e Lipjanit.

**Besmira Aliu nga organizata In Time** – Çështja e parë ka të bëj me ndarjen e buxhetit për financim të organizatave jo qeveritare që mirren me zhvillim ekonomik dhe me trajtim të grupeve të marginalizume.

**Tahire Grajqevci** – Kërkesa e ime është së ne kemi mungesë për ujë kërkoi ujësjellës për Ribarin e Madh.